



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 675, Datë 07.02.2020**

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Hapja e hetimit paraprak në tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës.

**Baza Ligjore:** Nenet 24 shkronja (d), 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të importit dhe tregtimit të GLN-së për automjete dhe përdorim familjar”,

**VËREN SE :**

Nisur nga disa shqetësime në median e shkruar mbi rritjen e çmimit të shitjes së GLN për përdorim familjar dhe automjete, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, vendosi të realizojë një monitorim në këtë treg në lidhje me çmimin e shitjes së produktit GLN.

Nga monitorimi në terren në pikat e tregtimit me pakicë të GLN-së, u vërejt një rritje e njëkohshme e çmimit të GLN-së, duke filluar nga data 14 janar 2020, si pasojë e luhatjes në bursë dhe rritjes së çmimit të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së. Kjo rritje vërtetohet edhe nga kuponat tatimor të shitjes së produktit GLN përpara dhe pas rritjes së çmimit.

Gjithashtu nga të dhënat e administruara nga DPD, në lidhje me importet e realizuara nga ndërmarrjet në tregun e brendshëm, vërehet se tregu i importit dhe shitjes me shumicë

është një treg shumë i përqendruar. Indeksi i përqendrimit HHI paraqitet në nivelin 2828 duke qenë në nivelet e një tregu me përqendrim të lartë.

Nga treguesi CR3, konstatohet se 3 nga ndërmarrjet me pjesë më të madhe tregu zotërojnë rreth 91% të tregut, pra kanë një fuqi të madhe tregu. Ky tregues, përgjithësisht përfshin të gjithë tregun e importit të GLN duke na dhënë një pamje të qartë të ndërmarrjeve të cilët kanë fuqi në këtë treg.

Sa më sipër, referuar strukturës shumë të përqendruar të tregut dhe rritjes së njëkohshme të çmimit të shitjes së GLN nga ndërmarrjet në treg, rezulton se në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së ka shenja të arsyeshme të një sjellje të mundshme antikonkurruese të ndërmarrjeve që operojnë në këto tregje, sjellje e cila mund të çojë në shkelje të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun e importit, depozitimit, shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janari 2019 deri në 31 janar 2020.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**